



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.461/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Afijete Sada-Gllogjani kryesues, Milena Đerić, dhe Zyhdi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Besart Ademi, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje VV, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës - LDK, me seli në Prishtinë, për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 16.02.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohen të bazuara ankesat e evidentuara si: Anr.461/21, Anr.462/21, Anr.463/21, Anr.464/21, Anr.465/21 dhe Anr.467/21, të gjitha të datës 14.20.2021, të paraqitura nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje VV, me seli në Prishtinë, për shkak të vazhimit të postimit të materialit zgjedhor në rrjetin social “Facebook” në ditën e heshtjes zgjedhore.

II. Subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës i shqiptohet gjobë, në lartësi prej 3,000.00 euro (tri mijë) dhe Detyrohet ta paguaj gjobën në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të këtij vendimi nën kërcënimin e dënimit shtesë.

A r s y e t i m

Me datë 14.02.2021, PZAP-i ka pranuar ankesat Anr.461/21, Anr.462/21, Anr.463/21, Anr.464/21, Anr.465/21 dhe Anr.467/21, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, me seli në Prishtinë, të paraqitura kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës-LDK, me seli në Prishtinë, në të cilat pretendon se përmes rrjeteve sociale Facebook, në llogaritë personale të kandidatëve për deputet nga radhët e këtij subjekti politik si dhe anëtarëve të partisë, respektivisht në llogarinë e: Lutfi Zharku për kandidaten për deputete Ardita Rrahmani, Islam Pacolli, Gentiana Azemi, Agmi Veliu dhe Aqif Shehu. Në kohëzgjatjen e heshtjes zgjedhore, kanë bërë fushatë në rrjetet social Facebook. Me këtë rast paraqitësi i ankesës thekson se është bërë shkelje e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Parashtruesi i ankesave si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara në cilësi të provave materiale.

Në përgjigjet në ankesë të ofruar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës të ankesës Anr.461/2021 deklarojnë se fotoja e postuar nga Lutfi Zharku nuk nënkupton reklamimin e sloganit e as reklamimin e numrit dhe formës zyrtare të kandidates për deputete znj. Ardita Rrahmani, më tutje pretendojnë se në foton e postuar nga z. Zharku së

bashku me znj. Rrahmani teksa prapa shihet një numër që është pjesë e shenjës së trafikut, si provë kanë bashkangjitur edhe një fotografi që tregon cili ka qenë slogani i LDK-së, numri i saj në këto zgjedhje. Për ankesën Anr.463/2021 deklarojnë se ankesa në fjalë është e pa bazuar se, Gentiana Azemi nuk është zëdhënëse për media (zyrtarisht me vendim). Më tutje pretendojnë se znj. Azemi nuk bën thirrje e as nxitje për të votuar LDK-në sepse askund nuk përmend fjalën voto. Më tutje pretendojnë se znj. Gentiana Azemi për të larguar çdo paqartësi eventuale, ka fshirë postimin e ankimuar dhe për këtë gjeni të bashkangjitur foto-dëshmin. Për ankesën Anr.464/2021 deklarojnë se heshtja zgjedhore fillon në ora 07:00 të mëngjesit të ditës se shtunë fiks 24 orë para hapjes së qendrës së votimit në këtë rast me 13 shkurtë të cilat pra hapën në ora 07:00 të ditës së diele. Për ankesën Anr.467/2021 deklarojnë se ankesa në fjalë është e pa bazuar për arsye se videoja e postuar nuk është në kundërshti me nenin 36 par.1 pika b). Andaj e njëjta thekson se ankuesi nuk argumenton asgjë në ankesë nuk ofron ndonjë provë të rëndësishme, nuk ka përshkruar as ditën e as orën e saktë veq se supozon për një veprim të tillë që sipas dëshmisë nuk dihet asgjë. Andaj e njëjta i propozon PZAP që ankesën e tillë ta refuzon si të pa bazuar.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të bazueshmerisë së ankesave dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, provave materiale – fotografive të bashkangjitur, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Ankesat janë të bazuara

Paneli, paraprakisht ka vlerësuar se ankesat: Anr.461/21, Anr.462/21, Anr.463/21, Anr.464/21, Anr.465/21 dhe Anr.467/21, të cilat për nga përmbajtja dhe natyra e shkeljes së pretenduar janë të njëjta, paraqitës i të gjitha ankesave është subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, dhe po ashtu të njëjtat janë paraqitur kundër subjektit të njëjtë politik, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), prandaj Paneli bazuar në nenin 8 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave Nr.02/2015, të PZAP-it, në të cilën përcaktohet se: *“Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave kryesuesi i panelit vendimmarrës mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme dhe se ato ankesa të trajtohen me një vendim”*, andaj Paneli bëri bashkimin e ankesave dhe për të njëjtat vendosi me një vendim, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga shkresat e lëndës shihet se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës dhe kandidatët për deputetet në Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e këtij subjekti, gjatë heshtjes zgjedhore dhe ditës së votimit në rrjetin e saj social Facebook kanë bërë fushatë zgjedhore dhe kanë udhëzuar që të votohet subjekti politik LDK dhe kandidatët e saj, të apostrofuuar në ankesa ku me këtë veprim ka bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Paneli, konform dispozitës së nenit 8 par. 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 02/2015, i verifikoj pretendimet e paraqitësit të ankesës, dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara, për faktin se në llogaritë e Facebook-ut, ashtu siç pretendon paraqitësi i ankesës, në ditën e heshtjes zgjedhore dhe në ditën e votimit janë hasur reklama politike, në gjithsej 6 shkelje, të cilat promovojnë subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dhe

kandidatët për deputet nga radhët e këtij subjekti politik, ku me këtë veprim kanë bërë thyerjen e heshtjes zgjedhore.

Në raport me pretendimet e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) se ankesat e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) janë të pa bazuara, këtë pretendim paneli e refuzon si të pa bazuar, për arsye se të njëjtit gjatë ditës së heshtjes zgjedhore kanë bërë thirrje që të votohet subjekti politik LDK dhe kandidatët e tyre.

Në raport me pretendimet e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), se postimet janë bërë më herët dhe jo me datë 13 apo 14 shkurt, dhe se te njëjtat kanë të drejtë të shfaqen nëse janë të postuara më herët, këtë pretendim paneli e refuzon si të pa bazuar. Në rastin konkret kemi të bëjmë me kandidatët për deputet që kanë postime gjatë datës 13 dhe 14 shkurt, datë e cila është heshtje zgjedhore. Me dispozita ligjore subjekteve politike apo kandidatëve të tyre iu ndalohe të bëjnë fushat, në një mënyrë apo tjetër, andaj në këtë rast postimet e publikuara në rrjete sociale edhe për datat 13 dhe 14, është shkelje e heshtjes zgjedhore, prandaj ankesat e subjektit politik Vetëvendosje janë pranuar si të bazuara.

Paneli, vendimin e tij e mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse, konform nenit 117 par.3 të LZP-së, andaj nuk i mori parasysh pretendimet e paraqitësit të përgjigjes në ankesë, pasi që nga ana e tyre nuk u ofrua ndonjë dëshmi e cila argumenton pretendimet e tyre.

Andaj PZAP-i duke marr parasysh këtë si dhe në mbështetje të dispozitave ligjore të LZP-së konstaton se Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), është përgjegjës për veprimet e tija, pasi që me veprimet e lartëcekura ka shkelur nenin 36 paragrafi 1 pika b) të LZP-së, që përcakton veprimet e ndaluara para procesit të votimit ku thuhet se 24 orë para hapjes së Qendrave të Votimit për hedhjen e votës, deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre u ndalohe bërja e fushatës në çfarëdo mënyre.

Paneli, me rastin e shqiptimit të gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, u mbështet në dispozitat e lart cituara, e në veçanti duke marr parasysh rrethanat e rastit siç janë:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj, në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Faktin se kemi të bëjmë me numrin e shkeljeve të përsëritura gjegjësisht 6 shkeljeve.
- Faktin se subjekti politik të cilit i është shqiptuar gjoba Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme,
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, vlerëson se gjoba e shqiptuar si masë, përveç aspektit të dënimit në raport me subjektin që nuk e ka respektuar Kodin e Mirësjelljes, shërben edhe si masë preventive që në të ardhmen subjektet politike të përmbahen nga veprimet që bien ndesh me rregullat ivën ligjore, që te mos cenohet heshtja zgjedhore duke siguruar klimë të qetë dhe të përshtatshme për votim të lirë si bazament i një procesi demokratik zgjedhor.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2

të LZP, i cili përcakton: “ 120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i.”

Paneli, mbi bazën e të dhënave të lartcekura në mbështetje të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.461/2021 më datë 16.02.2021

Kryesuese e Panelit
Afijete Sada Gillogjani

Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.

